

**AKTI I THEMELIMIT**  
**PËR SHOQËRINË "Bel Group" SHPK**  
**FORMIMI I SHOQËRISË**

Sot në Tiranë në datën 11 Prill 2024 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "Bel Group" shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

**1. Besar Baxhaja** shtetas Shqiptar I biri Ilirit , i datëlindjes 21.11.1985 lindur ne Tirane, Shqiperi. dhe banues ne Tirane, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID I51121038B.

**2.Elvi Mataj**, e biri e Birces shtetas Shqipëtar,i datëlindjes 26.04.1985 lindur në Tirane dhe banues në Tirane, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr pashaporte I50426141N.

**SELIA E SHOQERISE**

1.Shoqëria tregëtare " Bel Group " SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tirane, TIRANE ,Rr Kavajes Nr pasurie 4/160+3+14/2 Zona kadastrale 8220,volume 50 faqja 47 me vendim të ortakëve të shoqërisë , mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria Tregtare "Bel Group" SHPK., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

**KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 10000 lekë (dhjete mij lek) , i cili është tërësisht kapital financiar . Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota,ku njera kategori me vlerë nominale 5000 lekë (pese mije leke) dhe kuota tjetere 5000 (pese mije leke).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

**1.Besar Baxhaja**, zotërues i 1 (një) kuote apo 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji.

**2.Elvi Mataj**, zotërues i 1 (një) kuote apo 50% të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji.



### OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "Bel Group" shpk do të jetë :

-Tregeti e parfumeve.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të beje shtesa te ndryshme ose ndryshime te objektit te veprimtarise se saj duke bere ndryshimet perkatese ne statut.

### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

a- për ndryshime në statut

b- emërimin dhe shkarkimin e administratorit

c- miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.

d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit

e- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë , është **Besar Baxhaja** me afat 5 vjeçar me te drejtë ripërtëritje.

### BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij.

Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

### ORTAKET:

**Besar Baxhaja**

Besar Baxhaja



**Elvi Mataj**

Elvi Mataj

